



International Federation of  
Library Associations and Institutions

## Udhëzim për bibliotekat profesionale /programet mësimore të bibliotekonomisë

*Këto udhëzime janë nënshkruar nga Komiteti Profesional i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatës  
Ndërkombëtare të Bibliotekave dhe të Institucioneve (IFLA –s) në takimin*

*Gusht 2012*

### **Përmbledhje**

Këto udhëzime zëvendësojnë rishikimin e fundit dhe të rëndësishëm të vitit 2000, si dhe kanë të bëjnë me përfshirjen e materialit në programin e shkollës së bibliotekonomisë, për të pasqyruar zhvillimet në shërbimet e bibliotekës dhe të informacionit në shekullin e 21<sup>të</sup>. Udhëzimi përcakton jo vetëm strukturën e objektivave kryesore për programet mësimore të bibliotekës dhe të informacionit por edhe kërkesat kryesore për elementet thelbësore dhe te doemosdoshme të kurikulave, të përfshira në programet e mësimdhënies në shkollën e bibliotekonomisë ; kërkesat e studentëve dhe te stafit mësimdhënës për këto programe, si dhe nevojën për programe të mbështetura mire nga informacioni dhe burimet e tjera.

### **Përmbajtja**

Udhëzime për bibliotekat profesionale/Programet mësimore të bibliotekonomisë .....	1
Përmbajtja .....	1
Hyrje .....	2
Objektivat .....	3
Udhëzime .....	3
G1 Struktura e zgjeruar.....	3
G2 Elementet e programit .....	4
G3 Programi .....	5
G4 Fakulteti dhe stafi mësimdhënës .....	7

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licensës "Creative Commons Attribution 3,0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti , me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

G5 Studentët .....	8
G6 Mbështetja .....	8
G7 Burimet instruktuese dhe objektet .....	9
Bibliografia .....	10

## Hyrje

Programet mësimore të bibliotekonomisë (informacionit), kanë një histori të gjatë dhe të suksesshme. Në të shkuarën, ato janë përqëndruar tek zhvillimi i koleksioneve fizike të librave dhe materialeve të tjera, në ndërtimin e stafeve të bibliotekës nga njerëz të cilët kishin mësuar të përzgjidhnin, të pasuronin, të organizonin, të rigjenin dhe të qarkullonin këto materiale. Sot, programet mësimore të bibliotekonomisë dhe informacionit zgjerohen përtej koleksionit fizik dhe ndërtesave, tek bota virtuale e internetit. Në ditët e sotme përqëndrimi është tek sigurimi i informacionit për përdorues në kontekste të ndryshme: publik, privat dhe për grupimin e tretë; përdorues të cilët ndoshta nuk kanë mundësinë ose dëshirën për të hyrë në ndërtesën e bibliotekës ose ambientin e saj. Bashkëpunimi me partnerët brenda sektorit – arkiva, muze dhe menaxhues regjistrimesh – është dukshëm në rritje, kështu që përfshirja në programet e ndërgjegjësimit për çështjet e përbashkëta është e nevojshme. Programet mësimore janë ofruar në nivel teknik, në nivel diplome profesionale dhe në nivel kërkimor dhe doktoraturë. Së pari, udhëzimet e paraqitura këtu vlejné për programet e diplomës së nivelit të parë (Bachelor) dhe të dytë (Master), që të dyja këto çojné drejt një kualifikimi profesional.

Rishikimi i fundit dhe i rëndësishëm i këtyre udhëzimeve u bë në vitin 2002. Që nga ajo kohë profesioni i bibliotekarit është përballur me shumë probleme, ku jo i pakët ka qenë pikërisht integrimi i Internetit dhe teknologjive të tjera digjitale dhe gjithshka që ato sjellin me vehte në jetën tonë të përditshme. Kjo ka sjellë një shtysë nga ana e disa shkollave bibliotekare për të adoptuar një filozofi të “iSchool” (shkollës on-line), në konkurrencë me arsimin bibliotekar më shumë tradicional dhe akoma të vlefshëm, shpesh në të njëjtin vend. Për më tepër, është bërë e dukshme që shumë prej bazave të njohurive dhe të udhëzimeve që arsimimi në bibliotekonomi nevojitet të mbulojë, janë gjithashtu profesionet e të njëjtit lloj, për shembull: arkivat, muzeumet dhe menaxhimin e regjistrimeve. Gjithashtu, ekziston nevoja për të trajtuar mospërfshirjen e çështjeve kombëtare tek njohuritë bazë të programeve mësimore.

Komiteti i Përhershëm i Edukimit dhe Trajnimit të IFLA-s caktoi seksionet për të mbikëqyrur zhvillimin e një rishikimi tjetër të dokumentit. Anëtarët ishin: Profesor Gillian Hallam; Profesor S.B. Ghosh; Profesor Kerry Smith. Ky rishikim është paraqitur më poshtë.

Prof.As. Kerry Smith, FALIA

Përfaqësues, i seksionit të hartimit të Udhëzimit të IFLA-s, korrik 2012

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës “Creative Commons Attribution 3.0 Unported License”, e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## Objektivat

Qëllimi i këtyre udhëzimeve është t'u ofrojë studimeve bibliotekare dhe shkollave të shkencës së bibliotekonomisë nëpër botë një bashkësi parimesh udhëzuese të praktikës më të mirë, për tu përdorur për krijimin dhe zbatimin e programeve mësimore të tyre. Udhëzimet ofrojnë një strukturë për rishikimin dhe përmirësimin e programeve ekzistuese si dhe për krijimin e programeve të reja që mund të përdoren si një mënyrë praktike për krahasim. Gjithashtu, ato duhen të përdoren për të krijuar programe të reja mësimore për bibliotekat dhe sektorin e shërbimit të informacionit.

Dihet se disa vende kanë standarte të larta të arsimit, që duhet të respektohen gjithashtu nga shoqatat profesionale të të njëjtës disiplinë, por në vende të ndryshme dhe që kanë politikatat e tyre arsimore për shkollat e bibliotekave dhe të informacionit të cilat duhet t'i përmbahen veçanërisht për qëllimet e akreditimit. Parashikohet që parimet në këtë grup të udhëzimit do të formojnë bazën për kërkesat kombëtare të akreditimit.

## Udhëzime

Udhëzimi përmban:

- G1 Struktura e zgjeruar
- G2 Elementet bazë në programet e shkencës së informacionit dhe bibliotekave
- G3 Programi
- G4 Fakulteti dhe stafi mësimdhënës
- G5 Studentët
- G6 Mbështetja
- G7 Burimet instruktuese dhe objektet

## G1 Struktura e zgjeruar

### Objektivat

Në nivel organizativ, statusi dhe përshkrimi i programit mësimor bibliotekar /informacionit duhet të jetë i krahasueshëm me atë të programeve të tjera të vendit, që janë të përfshira në edukimin profesional. Për përgatitjen e nivelit profesional, programi arsimor për biblioteka/informacion duhet të jenë pjesë e një institucioni që jep diploma dhe instruksioni duhet të jetë për nivel universitar. Shkallë-dhënie dhe instruksionet duhet të jenë në nivel terciar (universitar). Programet për biblioteka/informacion duhet të kenë të drejtën për të ofruar studime të nivelit të doktoraturës mbi të njëjtën bazë si programet e tjera.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## Parimet

**Misioni.** Misioni i programit mësimor të bibliotekonomisë/ informacionit duhet të shprehet qartë në një dokument zyrtar për publikun. Programi duhet të trajtojë qëllimin e tij mësimor në një kontekst më të gjerë politik, social, ekonomik, teknik dhe duhet të jetë në përputhje me vlerat jo-diskriminuese të profesionit. Ai duhet të identifikojë përfaqësuesit e tij duke i shërbyer me devotshmëri nevojave të vendit dhe organizatave të pavarura, jo-fitimprurëse, si dhe duhet të jetë në përputhje me parimet e institucionit të tij mëmë. Programi i shkencës së bibliotekonomisë dhe informacionit duhet të pasqyrojë lidhjet me profesionet dhe disiplinat e përafërta.

**Qëllimet dhe objektivat.** Programi mësimor i bibliotekës / informacionit duhet të parashtrojë objektivat e tij si dhe të identifikojë objektivat më specifike, që rrjedhin nga qëllimi i tij, duke ju adresuar filozofisë, primeve dhe metodikës së programit, fushës së specializimit, nivelit të përgatitjes së akumuluar, mësimdhënies, vlerave të shërbimit dhe kërkimit, si dhe perceptimit të rolit të bibliotekës dhe shërbimeve të informacionit në shoqëri. Qëllimet dhe objektivat duhet të jenë në përputhje me deklaratat e botuara nga organet zyrtare të akredituara në lidhje me politikat arsimore. Ato, gjithashtu duhet të plotësojnë rezultatet mësimore sipas studentëve të diplomuar dhe shkallës së nivelit të diplomimit të institucionit dhe të shtetit përkatës.

**Planifikimi dhe vlerësimi.** Programi duhet të ketë një proces vlerësimi dhe planifikimi periodik të zhvilluar në mënyrë të qartë. Procesi duhet të përfshijë një rishikim të vazhdueshëm të politikave dhe procedurave nën dritën e ndryshimeve të parashikuara në fushën e bibliotekës/informacionit dhe më gjërë në shoqëri. Stafi mësimdhënës dhe studentët duhet të përfshihen në procesin e planifikimit dhe vlerësimit. Gjithashtu edhe punëdhënësit dhe profesionistët duhet të konsultohen. Programi duhet të përputhet me kriteret e akreditimit profesional/edukativ sipas standarteve të vendit.

## G2 Elementet e programit

### Objektivat

Është e rëndësishme që elementet bazë të programit të jenë renditur si më poshtë:

- Të përfshijnë metodat e mëparshme si një mënyrë për të kaluar tek metodat në mjedisin e digjitalizuar;
- Të gërshetojnë dijet dhe traditat kombëtare në program;

### Parimet

Elementet bazë të programit të shkencës së informacionit dhe bibliotekonomisë do të përfshijnë:

1. Ambjentin informativ, impaktin social të shoqërisë së informacionit, etikën dhe politikën informative, si dhe historinë e shkencës.
2. Gjenerimin i informacionit, komunikimin dhe përdorimin.
3. Vlerësimin e nevojave të Informimit dhe projektimin e shërbimeve.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

4. Proçesin e dhënies së informacionit.
5. Menaxhimin e burimeve të informacionit që përfshin: organizimin, përpunimin, rigjetjen, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e informacionit sipas formave dhe formateve të ndryshme të tij.
6. Kërkimin, analizimin dhe interpretimin e informacionit.
7. Aplikimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në të gjitha aspektet e dhënies të informacionit dhe shërbimit në bibliotekë.
8. Menaxhimin e dijeve.
9. Menaxhimin e agjensive të informacionit
10. Vlerësimin sasior dhe cilësor të rezultateve të përdorimit të informacionit dhe bibliotekës.
11. Ndërgjegjësimin në lidhje me “Paradigmat” e dijeve kombëtare

Përshkrimi dhe përfshirja e gjithë elementeve të sipërpërmendur të programit, është përtej qëllimit të këtij dokumenti . Megjithatë udhëzimi i mëposhtëm është ofruar në lidhje me elementin bazë 11: Ndergjegjësimi në lidhje me “Paradigmat” e dijeve kombëtare, që të përfshijë:

- Ndergjegjesimin në lidhje me “Paradigmat” e dijeve kombëtare

Fushëveprimi përfshin:

- Kuptimin e rëndësisë, larminë e strukturës së dijeve kombëtare
- Ndikimin e proçeseve kombëtare, filozofisë dhe gjuhës që janë të rëndësishme në kuadrin e strukturës së dijeve kombëtare
- Rëndësia e përdorimit të metodologjive kërkimore vendase kur hulumtojnë nevojat e burimeve dhe shërbimeve të informacionit tek përdoruesit vendas.

Këto karakteristika do të shtohen më tej sipas vlerave. Megjithëse, është e rëndësishme të theksohet se siç ka disa elemente të përbashkëta të komuniteteve vendase ka gjithashtu edhe një shkallë të lartë ndryshimesh. Kështu që, çdo komunitet vendas do të ketë vlerat dhe tematikat e veta (të shprehura në gjuhën e tij, sipas veçorive kulturore). Por nga ana tjetër, vlerat thelbësore të përbashkëta dhe tematikat rreth vendasve përfshijnë: trashëgiminë, përgjegjësinë, legjitimitetin, risinë, respektin dhe gjuhën (Lilley, 2012).

### **G3 Programi**

#### **Objektivat**

Programi do të përbëhet nga një seri e unifikuar e kurseve dhe përvojave të tjera mësimore bazuar në qëllimet dhe objektivat e programit. Ajo duhet të pajisë studentët me një kuadër teorik për kërkimin shkencor dhe praktikën në fushën e bibliotekonomisë/ informacionit. Mundësitë për të fituar dhe demonstruar aftësitë profesionale duhet të jenë pjesë e programit mësimor. Programi duhet të karakterizohet nga një ndërgjegjësim për problemet profesionale.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licensës “Creative Commons Attribution 3,0 Unported License”, e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti , me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## Parimet

**Dokument publik;** Programi duhet të deklarohet qartësisht me anë të një dokumenti zyrtar të disponueshëm publikisht, ku të përshkruhen qëllimet, kushtet paraprake, përmbajtja, rezultatet e mësimit dhe metodat e vlerësimit për secilin kurs brënda kuadrit të programit.

**Hapësira e arsimit të përgjithshëm;** Studentët duhet të sigurojnë një edukim arsimor të gjërë (me njohuri nga disiplinat e tjera), si një komponent i rëndësishëm i programit mësimor profesional për biblioteka / informacion.

**Kurset bazë për bibliotekë/informacion;** Programet duhet t'i referohen deklarimeve të politikave arsimore të aprovuara nga qeveria ose nga shoqatat profesionale që kanë njohuri të rëndësishme dhe dëshmojnë elemente aftësie.

**Praktikumi, puna praktike ose puna në terren ;** Programi duhet të përfshijë mjetet e duhura për të lejuar studentët që në një mënyrë praktike të vlerësojnë ndërveprimin mes teorive profesionale dhe zbatimin e tyre në praktikën profesionale. Ajo gjithashtu mund të përfshijë projekte kërkimore të aplikuara si dhe projekte që përfshijnë aktivitete të mirëfillta praktike, në varësi të rezultateve të kërkuara nga të mësuarit, në një mjedis pune.

**Aftësitë e fituara;** Metodatat e mësimdhënies si dhe të vlerësimit duhet të hartohen për të zhvilluar ose për të rritur aftësitë komunikuese ndërpersonale të studentëve, aftësitë për të punuar në grup dhe aftësitë për të menaxhuar kohën dhe detyrat. Në nivel profesional, theksi duhet të vihet në zhvillimin e aftësive analitike të studentëve si dhe zgjidhjen e problemeve.

**Metodat e mësimdhënies;** Aty ku do të përdoren metodatat e mësimdhënies në distance dhe "online"(Internet), përmbajtja e programit dhe cilësia e metodës së mësimdhënies duhet të jetë e krahasueshme me përvojat e ofruara në rrjet. Dokumentacioni për oferta të tilla duhet të përcaktojë qartë kërkesat në lidhje me teknologjinë, për këtë kategori studentësh.

**Vazhdimi i arsimimit;** Për të ndihmuar bibliotekarët dhe specialistët e informacionit në praktikë , për të ruajtur kompetencat në një shoqëri në ndryshim dhe për të mbajtur mësimdhënësit në dijeni për çështjet dhe prirjet në praktikë, programi duhet të lidhet me seminare (Workshop), dhe kurse të shkurtra në dobi të bibliotekarëve dhe të specialistëve të informacionit, ose me partnerë dhe agjensi që zhvillojnë aktivitete te tilla.

**Rishikimi i rregullt i programit;** Një proces i rishikimit zyrtar të programit duhet të zhvillohet në mënyrë të rregullt, kështu që rishikimi i ardhshëm duhet të bëhet në vitin 2017 ose pas këtij viti. Ky rishikim duhet të mbështetet me të dhëna nga punëdhënësit, specialistët dhe shoqatat profesionale, si dhe nga studentët dhe fakulteti/shkolla nën mbikqyrjen e Komitetit të Standardeve të IFLA-s.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti , me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## G4 Fakulteti/shkolla dhe stafi

### Objektivat

Stafi mësimdhënës i programit duhet të ketë status dhe autoritet të krahasueshëm me njësi të ngjashme të institucionit mëmë. Stafi akademik dhe shkencor duhet të ketë të dy kualifikimet akademike dhe profesionale të krahasueshme me ato që kërkohen në fakultet dhe aftësi administrative dhe udhëheqëse.

### Parimet

**Stafi akademik.** Numri i stafit akademik (mësimdhënës) duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur objektivat e programit. Kualifikimi i çdo anëtari të stafit të fakultetit që punon me kohë të plotë, duhet të përfshijë aftësitë kërkimore në fushën e mësimdhënies, aftësi në teknologji, efektivitet në mësimdhënie, sigurimin e dijeve të qëndrueshme, si dhe pjesëmarrje aktive në shoqatat përkatëse profesionale. Për mësuesit e programeve në nivel profesional, sigurimi i dijeve të qëndrueshme parashikohet të krahasohet me mësimdhënësit universitarë të disiplinave të tjera.

**Drejtuesi i programit.** Drejtuesi i programit duhet të ketë statusin dhe autoritetin të krahasueshëm me kryetarët e njësive të ngjashme të institucionit mëmë. Drejtuesi i programit duhet të ketë të dy kualifikimet, si atë akademik ashtu edhe atë profesional, të krahasueshëm me ato që kërkohen për fakultetin/shkollën, si dhe aftësinë administrative dhe udhëheqëse.

**Emërimet në Fakultet/Shkollë.** Rishikimi dhe Promovimi i Politikave. Programi mësimor duhet të ketë të deklaruar politikat dhe standardet për emërimin, rishikimin dhe promovimin e personelit me kohë të plotë, të ekuivalentuar me ato të njësive të krahasueshme. I gjithë stafi akademik/mësimdhënës me kohë të plotë duhet të mbajë gradë shkencore në fushat përkatëse, nga institucionet akademike të njohura. Duhet të jetë një politikë e deklaruar në mënyrë të qartë për edukimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit akademik mësimor, si dhe për të rishikuar aktualitetin e kurseve përkatëse dhe metodave të mësimdhënies.

**Emërimet me kohë të pjesshme.** Stafi me kohë të pjesshme duhet të jetë i kualifikuar siç duhet dhe duhet të balancojë e të plotësojë kompetencat e mësimdhënies, si stafi me kohë të plotë. Të dhënat e stafit me kohë të pjesshme duhet të jenë të koordinuara me programin në tërësi .

**Stafi jo-akademik.** Stafi jo-akademik (punonjësit, sekretaret, teknikët) duhet të ketë kualifikime ekuivalente me ato të stafeve të njësive të krahasueshme. Numri i personelit dhe lloji duhet të jetë i përshtatshëm për të mbështetur fakultetin/shkollën për kryerjen e detyrave përkatëse.

**Konsulenca.** Stafi i programit duhet të ketë mundësinë për të ofruar konsulencë për bibliotekat dhe agjensitë e informacionit, për të zhvilluar më tej bashkëveprimin ndërmjet institucionit arsimor dhe praktikës.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## **G5 Studentët**

### **Objektivat**

Përzgjedhja e studentëve duhet të bazohet në kriteret e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe publike, ku interesi, aftësia, prejardhja intelektuale dhe arsimore si dhe diversiteti duhet të evidentohen.

### **Parimet**

**Politikat akademike.** Rekrutimi, pranimi, ndihma financiare, vendosja dhe politikat e tjera akademike dhe administrative për studentët duhet të jenë në përputhje me misionin, qëllimin dhe objektivat e programit të edukimit dhe të institucionit arsimor në tërësi, si dhe duhet të jenë në mënyrë të qartë jo-diskriminuese. Politikat duhet të reflektojnë nevojat dhe vlerat e komunitetit, të cilëve i shërben programi. Politikat duhet të jetë në dispozicion të publikut.

**Pranimi.** Përzgjedhja e studentëve duhet të bazohet në kriteret e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe që janë në dispozicion të publikut. Interesi, aftësia, prejardhja intelektuale dhe arsimore si dhe diversiteti duhet të shprehen tek kriteret. Standardet për pranim duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

**Programi i studimit.** Studentët duhet të kenë asistencë këshilluese në ndërtimin e një programi koherent të studimit, për të përmbushur aspiratat e karrierës në përputhje me misionin qëllimin dhe objektivat e programit arsimor.. Vlerësimi i arritjeve të studentëve duhet të sigurohet mbi një bazë të qëndrueshme dhe të barabartë. Vlerësimi i programit nga studentët dhe ish-studentët (të diplomuarit), duhet të bëhet herë pas here.

**Plotësimi i kërkesave.** Një deklaratë e qartë për kërkesat e programit arsimor duhet të paraqitet si një dokument zyrtar që është në dispozicion të studentëve aktual si dhe të atyre që do të vijnë. Me plotësimin e kërkesave, studentëve duhet t'i jepet një dëshmi, diplomë ose çertifikatë që është e përshtatshme për nivelin e tyre të studimit.

## **G6 Mbështetja**

### **Objektivat**

Programet mësimore të bibliotekës janë zakonisht pjesë e një entiteti të madh arsimor brenda institucionit të tyre dhe si pasojë kërkojnë të sigurojnë mbështetje të një cilësie shumë të lartë.

### **Parimet**

#### **Administrimi dhe financa.**

Administratorët, fakulteti dhe stafi i programit mësimor për bibliotekat / informacion duhet të jenë të vetëdijshëm, edhe për komunikimin me profesione dhe disiplina të tjera të lidhura, brenda dhe jashtë institucionit arsimor. Përveç kësaj, programi duhet të zërë një pozicion të veçantë në planin e organizimit administrativ të institucionit. Ai duhet të ketë një autonomi të mjaftueshme për të siguruar integritetin intelektual të programit që është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e tij.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*



**Drejtimi.** Vendimet duhet të bazohet në politikat e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të deklaruara publikisht. Pjesëmarrja e stafit të fakultetit, e studentëve , e ish- studentëve dhe drejtuesve në vendimarrje duhet të inkurajohet. Vendimet dhe aktivitetet kryesore duhet të jenë të dokumentuara.

**Mbështetja financiare.** Programi mësimor duhet të ketë mbështetje të mjaftueshme financiare për të zhvilluar dhe për të ruajtur një kurs të studimeve për bibliotekonomi/ informacion në përputhje me kërkesat e praktikës dhe të krahasueshme me programe të ngjashme në vende të tjera. Një buxhet vjetor duhet të administrohet nga drejtuesi i programit. Niveli i mbështetjes duhet të jetë i lidhur me numrin e studentëve, stafit mësimdhënës, stafit administrativ dhe ndihmës, pajisjeve mësimore dhe ambienteve.

## **G7 Burimet instruktuese dhe mjetet ndihmëse**

### **Objektivat**

Burimet instruktuese dhe mjetet ndihmëse për programet mësimore të shkencës së bibliotekonomisë/informacionit duhet të jenë bashkëkohore, në sasinë dhe cilësinë e duhur si dhe në funksion dhe në mbështetje të kurseve të ofruara nga programi mësimor dhe të përpjekjeve për kërkim shkencor në fakultet.

### **Parimet**

**Burimet e bibliotekës.** Studentët dhe fakultet duhet të kenë qasje në burimet aktuale të bibliotekës përkatëse, që mbështet aspektet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të programit mësimor. Këto duhet të përfshijë botimet në format të shtypur dhe elektronik; një numër të bibliografive dhe qasjen në Internet, si dhe në media të tjera të përshtatshme për të mbështetur mësimdhënien dhe punën kërkimore. Një procedurë për qasje në burime shtesë nga vende të tjera duhet të jetë efektive.

**Burimet e teknologjisë së informacionit.** Pajisjet kompjuterike, programet dhe burimet multimediale duhet të jenë të disponueshme për studentët, stafin dhe duhet të jenë të mjaftueshme për nivelin e kërkuar të përdorimit, për kurset e mësimin dhe të kërkimit shkencor në fakultet.

**Burimet e internetit.** Është e nevojshme një qasje e mjaftueshme në Internet si dhe një disponueshmëri për fakultetin dhe studentët. Duhet të formulohet dhe të publikohet një politikë në lidhje me lejen e përdorimit të burimeve të internetit për mësim dhe kërkim shkencor, duke theksuar këtu edhe shqetësimet e bibliotekarëve për lirinë e informacionit.

**Mjediset.** Mjediset për zhvillimin e programit mësimor duhet të sigurojnë hapësirën e duhur për stafin dhe studentët për të përmbushur objektivat e tyre.

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*

## **Bibliografia:**

Australian Library and Information Association (ALIA) see:  
<http://www.alia.org.au/education/courses/accreditation.html> and  
<http://www.alia.org.au/education/courses/criteria.html>

Chartered Institute of Library & Information Professionals (CILIP) (formerly the Library Association (UK)) see: <http://www.cilip.org.uk/jobscareers/qualifications/accreditation/Pages/default.aspx>

Lilley, A.S. (2012). *Introducing "Awareness of Indigenous Knowledge Paradigms" IFLA core elements*. Available from: [s.c.lilley@massey.ac.nz](mailto:s.c.lilley@massey.ac.nz)

Medical Library Association (US), see: <http://www.mlanet.org/education/policy/>

Special Libraries Association (US), see:

<http://www.sla.org/content/learn/members/competencies/index.cfm>

*Udhëzim për Bibliotekat Profesionale/Programet Mësimore të Bibliotekonomisë/Informacionit 2012*

*E drejta e autorit në këtë dokument i përket IFLA-s. Përdorimi i dokumentit bëhet sipas kushteve të licencës "Creative Commons Attribution 3.0 Unported License", e cila nënkupton që ju keni të drejtë që ta kopjoni, shpërndani, transmetoni, përshtatni dhe të bëni përdorim komercial të këtij dokumenti, me kusht që çdo përdorim të bëhet me lejen e IFLA-s. Për të parë një kopje të kësaj licence, vizitoni: <http://creativecommons.org/licenses/by/3.0/>. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, ju lutem kontaktoni selinë e IFLA-s.*